

Ne fokus/ Tifozet e Tiranes akuza per kryebashkiakun Basha

nga AlbaniaSoccer
E diel, 10 Nentor 2013 20:30



Sapo ka perfunduar ndeshja ne Kukes, tifozet e Tiranes kane nxjerre nervat me lojtaret bardheblu ndersa pas takimit komentet kunder drejtuesve dhe kryetarit te Bashkise Lulezim Basha kane qene te shumta. Gjendja e Tiranes eshte kaotike. Pas fazes se pare te kampionatit bardheblute jane te fundit ne renditje dhe tani rrezikojne renien. Kjo situate ka acaruar tifozet qe kane nisur ti kerkojne llogari kryebashkiakut ne facebook dhe shume prej tyre nuk i kane kursyer as ofendimet.